



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.874/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrrisë, Behar Duraku, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Vushtrri, paraqitur kundër vendimit Nr.2948/2021 të datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli Anr.874/2021, i paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrrisë, Behar Duraku, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Vushtrri, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Komunën e Vushtrrisë, në Vendvotimet: nr.2710B/02R dhe 2707B/01R.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë e Vendvotimeve si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.874/2021, kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrrisë, Behar Duraku, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me nr.34, dega në Vushtrri, në të cilën pretendon se në fshatin Stroc, Komuna e Vushtrrisë në vendvotimin 2710B/02R në shkollën fillore Migjeni në Stanoc të Epërm i ka 2 vota, mirëpo në rezultatet e shpallura nuk i figurojnë. Lidhur me këtë pretendim thekson se e dëshmon në bazë të votuesve Muhamet dhe Fikrije Haradinaj të cilët kanë dëshmuar se e kanë votuar. Në vendvotimin 2707B/01R në Dumnicë të Epërme pretendon se në fletat e vëzhguesve i'u janë shënuar 7 vota ndërsa në publikim të rezultateve i'u janë shënuar 4 vota, kurse kandidatit me nr.5 në fletat e vëzhguesve ka 0 vota, kurse në publikim të rezultateve iu janë shënuar 3 vota dhe këtij kandidati iu është mundësuar pranimi në listën e anëtarëve për Kuvend Komunal për shkak që ka dalur 3 vota më shumë se ai. Parashtruesi i apelit kërkon që ti rinumërohen vendvotimet e cekura në apel.

Andaj përmes apelit ka kërkuar që të bëhet rinumërimi në Vendvotimet nr.2710B/02R dhe 2707B/01R

Si provë ka bashkangjitur formularët për shënimin e votave nga vëzhguesit

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli vlerësoi se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që, pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, si dhe nga hetimi i bërë në materialet zgjedhore, ka konstatuar se ka mungesë të votave të kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal të Komunës së Vushtrrisë. Behar Duraku nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), siç rezultoi edhe nga provat e ofruara si dëshmi nga vetë pala ankuese, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatin Behar Duraku, nga Subjekti Politik LDK, dega në Komunën e Vushtrrisë, në Vendvotimet: nr.2710B/02R dhe 2707B/01R, dhe rezultati i dalur nga ky rinumërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale, të vitit 2021.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezultoi se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr. 874/2021 më datën 06.11.2021.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimin të këtij vendimi.